



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL

Tiranë, më 01.11.2022, ora 15:00

Drejton mbledhjen Sokol Binaj – Kryetar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

Rendi i Ditës:

- 1. Miratimin e Raportit për renditjen e kandidatëve të lejuar për plotësimin e vendit vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datë 13.01.2022.*
- 2. Të tjera.*

Marrin pjesë:

- | | |
|--------------------------|----------------------|
| 1. Sokol Binaj | (Kryetar) |
| 2. Marsida Xhaferllari | (zëvendës kryetare) |
| 3. Anila Leka | (anëtare) |
| 4. Elsa Toska | (anëtare) |
| 5. Edlira Petri | (anëtare) |
| 6. Klodiana Mema (Veizi) | (anëtare) |
| 7. Etien Kapo | (anëtar) |
| 8. Enton Dhimitri | (anëtar) |
| 9. Genti Xholi | (anëtar zëvendësues) |
| 10. Sandër Simoni | (anëtar zëvendësues) |
| 11. Altin Binaj | (anëtar zëvendësues) |

Marrin pjesë si vëzhgues të përhershëm:

1. Përfaqësuesja e Avokatit të Popullit, Erinda Ballanca
2. Përfaqësues i Delegacionit të BE-së, Ili Gërdupi

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016:

1. **Alket Jaupi** - përfaqësues me autorizim i Presidentit të Republikës së Shqipërisë;
2. **Mimoza Arbi** – përfaqësuese e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;

Me pjesëmarrjen e përfaqësues së OPDAT, përfaqësuesja **Klodiana Vogli**.

HAPET MBLEDHJA: ora 15:00

Kryetari Sokol Binaj – Atëherë vazhdojme me rendin e ditës së mbledhjes të caktuar për sot “*Miratimin e Raportit për renditjen e kandidatëve të lejuar për plotësimin e vendit vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datë 13.01.2022*”.

Verifikojmë prezencën e pjesëmarrësve.

Të pranishëm janë : zonja Xhaferllari, zonja Toska, zonja Leka, zonja Petri, zoti Dhimitri, zoti Xholi, zoti Kapo, zonja Mema dhe Binaj.

Prezent është Avokatia e Popullit, zonja Erinda Ballanca. Përfaqësuesja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë zonja Arbi. Prezent është dhe përfaqësuesi i Delegacionit të BE-së zoti Ili Gërdupi dhe përfaqësuesja e OPDAT-it, zonja Klodiana Vogli.

Sokol Binaj – atëherë, propozoj të mos fillojmë me pikën e parë por duke kaluar tek pikat e tjera një propozim që ngriti zonja Toska. Ta trajtojmë atë, ti japim zgjidhje dhe më pas shkojmë tek miratimi formal i relacionit të raportit lidhur me renditjen e kandidatëve për plotësimin e vendit vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës. Zonja Elsa fjala për ju.

Elsa Toska – Faleminderit, zoti Kryetar! Për shkak të faktit si relatore e vakancës më është dashur të bëj dhe arsyetimin e vendimeve dhe përfundimisht pikëzimin e anëtarëve ta përkthej në pikë, konstatova që tek kandidatja Arta Marku pikërisht në pikëzimin që i kam dhënë unë në angazhime shtesë, ishte bërë një gabim material dhe ishte hedhur vlerësimi me zero pikë. Në fakt , vlerësimin për këtë kandidate e kam bërë me 2 pikë për angazhimet shtesë, dhe në formularin e përgjithshëm të plotësuar nga të gjithë anëtarët e KED-it, në përmbledhje pra, të të gjithë pikëve për të gjithë komponentët vullneti im nuk reflektohet as i investuar, as i deformuar, pra, është ai që është për pikëzimin megjithatë është bërë një gabim material në hedhje, kështu që propozoj korigjimin e këtij gabimi. Faleminderit!

Sokol Binaj- ka ndonjë gjë për diskutim, jeni dakort me propozimin e bërë nga zonja Toska?

Anëtarët të gjithë dakort.

Sokol Binaj – Anëtarët dakort me propozimin e zonjës Toska dhe të procedohet me plotësimin korigjimin e atij gabimi, duke vendosur në kolonën e pikëve tek angazhimet nga 0 në 2 pikë.

Konstatohet gjithashtu dhe prezenca e dy anëtarëve zëvendësues Sandër Simoni dhe Altin Binaj.

Sokol Binaj – atëherë, kalojmë tek pika kryesore e rendit të ditës lidhur me miratimin e raportit për renditjen e kandidatëve të lejuar për plotësimin e vendit vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datë 13.01.2022.

Renditja e kandidatëve u bë ditën e klasifikimit, me renditjen si më poshtë:

Genti Ibrahimi	- 88.38 pikë
Arta Vorpsi	- 88.22 pikë
Arta Marku	- 82.66 pikë

Atëherë, jeni dakort atëherë me raportin?

Anëtarët të gjithë dakord

Sokol Binaj – Unanimisht u vendos miratimi i raportit për renditjen e kandidatëve të lejuar për plotësimin e vendit vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datë 13.01.2022 dhe dërgimin e këtij raporti organit të emërtës Presidentit të Republikës, për të proceduar në lidhje me përzgjedhjen e kandidaturës së bashku me dokumentacionin shoqërues.

Sokol Binaj – atëherë konkludojmë edhe një datë për mbledhjen tjetër, duke qenë se jemi gati për relacionet e zonjës Mema, vakancat e shpallura nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Mbledhja e radhës caktohet ditën e Hënë, datë 07 Nëntor, ora 15.00,

Deklaroj të mbyllur mbledhjen për sot.

Tiranë më datë 01.11.2022, ora 15.00.

KRYETAR

Sokol BINAJ

